



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department Slobodnih Profesija - Department of Freelance Professions
Komisioni Disiplinor/ Disiplinska Komisija/ The Disciplinary Committee

DPL.nr.01/2023

KOMISIONI DISCIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Agron J. Hoxhaj – Zëvendëskryesues i Komisionit Disiplinor, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha – anëtarë të Komisionit Disiplinor, procesmbajtësin, Admir Sadiki, duke vendosur në çështjen juridike disiplinore sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë (MD) me seli në Prishtinë të iniciuar sipas kërkesës së palës ankuese, me seli në _____ për fillimin e procedurës disiplinore kundër përmbaruesit privat _____ nga _____, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në _____ për shkak të shkeljes së supozuar disiplinore nga neni 368 i Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), në prezencën e përfaqësueses së autorizuar të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës – Departamenti për Profesione të Lira, Burbuqe Spahija Kërveshi, Zyrtare e lartë në Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat dhe në cilësi të propozueses për fillimin e procedurës disiplinore, përfaqësuesve të palës ankuese, _____ dhe _____ që të dytë nga _____, dhe në prezencën e përmbaruesit privat _____ si dhe të autorizuarve të tij, _____ dhe av. _____ që të dytë nga _____ pas përfundimit të seancës dëgjimore të mbajtur me dt.16.02.2023 ndërsa seancën për Këshillim dhe Votim të mbajtur me dt.23.02.2023, me shumicë të votave të anëtarëve të Komisionit Disiplinor të MD-së, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara Raporti, DPL.nr.01/2023 i dt.10.01.2023 i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës – Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesi privat, _____ nga _____ dhe kërkesa e dt.10.01.2023 e palës ankuese, _____ me seli në _____ për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, _____ nga _____

II. Përmbaruesi privat, _____ nga _____ dhe organ përmbarues, i emëruar Përmbarues privat për territorin e Gjykatës Themelore në _____, është **PËRGJEGJËS** për shkelje disiplinore pasi që gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore në kuadër të aktivitetit të tij, nuk iu ka përmbajtur ligjit, në lëndën e përmbarimit, P.nr.001/2020, në atë mënyrë që të njëjtit, i shqiptohet, Masa disiplinore, Shkarkimi nga detyra.

III. Vendimi hyn fuqi nga dita kur i njëjti bëhet i formës së prerë.

Arsyetim

Pretendimet e palës ankuese.

Pala ankuese, me seli në _____ në vazhdim të tekstit _____ përmes përfaqësuesit të tij, fillimisht me dt.06.01.2023 në adresë të Ministres së Drejtësisë me seli në Prishtinë dhe Odës së Përmbauesve Privat, ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbauesit Privat, _____ nga _____ dhe letrën njoftuese në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit për transfer me shenjën, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 nga Llogaria e _____ (në likuidim) në _____ dhe se në këtë kërkesë, ka shprehur shqetësimin e saj në lidhje me ekzekutimin e pagesës nga ana e _____; cila e ka lejuar Urdhrin për transfer të përmbauesit privat, _____ në lëndën përmbaore, të kreditorit, _____ me numër të regjistrimit të biznesit _____ me adresë, _____ Sipas njoftimit nga _____ e të pranuar me 30 dhjetor 2022, me datë 29 Dhjetor 2022 nga _____ nga Llogaria bankare e _____ (në likuidim) nën administrimin e _____ janë transferuar 3,500,632.50 €, në llogarinë e _____ nr _____ dhe se kësaj kërkesë ia ka bashkagjitur, kopjen e komunikimit me email i dt.3.11.2015 nga _____ për _____ lidhur me njoftimin për dërgimin e Udhëzimit të Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme me nr. C – IV - 14-1607 të dt. 15 tetor 2015 për të gjithë gjithë Përmbauesit privat që duhet t'i përmbahen këtij Udhëzimi e që ka të bëjë me çështjen e pezullimit të të gjitha procedurave administrative gjyqësore apo të arbitrazhit, kopjen e fletëkthesës së Dhomës së Posaçme, C – IV - 14-1607 të dërguar në adresë të _____ për dërgimin e këtij Udhëzimi si dhe kopjen e Udhëzimit, C – IV - 14-1607 të dt.15 tetor 2015 të Dhomës së Posaçme.

Pala ankuese, me seli në _____ pas kërkesës së MDsë për plotësimin e kërkesës së dt.06.01.2023, me dt.10.01.2023 e ka bërë bërë kërkesën tjetër për inicimin e procedurës disiplinore ndaj këtij Përmbauesi Privat e në të cilën, ka sqaruar në mënyrë kronologjike procedurën para inicimit të procedurës disiplinore e deri te ndërmarja verpimit të fundit të përmbaimit të Përmbauesit Privat, _____ nga _____ Urdhrit për transfer me shenjën, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 për transeferimin e mjeteve monetare në shumën prej 3,500,632.50 € nga llogaria bankare e Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) _____ me se në _____ dhe se pas Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të pranuar nga _____ dhe ekzekutuar më datë 29 dhjetor 2022, _____ më datën 30 dhjetor 2022, ka paraqitur Kallëzim Penal ndaj disa zyrtarëve dhe kërkesë për Urdhër të Përkohshëm Ndalimi në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë e kësaj, Prokuroria Speciale ka nxjerrë, Urdhrin, PPS.nr.1/23 të dt.04.01.2023, urdhër e përmes të cilit ndalohet tërheqja e mjeteve nga Llogaria Bankare e Përmbauesit Privat, _____ si dhe po ashtu "ndalohet çdo aktivitet i mëtejshëm i llogarisë bankare që ka pranuar fonde nga kjo llogari e lartcekur lidhur me përmbaimit, P.nr.001/20 të datës 29 dhjetor 2022".

Në arsyetimin për parashtrimin e kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj këtij Përmbauesi privat, pala ankuese, _____ me seli në _____ ka cekur se _____, konsideron se përmbauesi privat, _____ me rastin e nxjerrjes së Urdhrit për transfer me nr. P.nr.001/20 e të cilin _____ e ka aprovuar e si të tillë e ka lejuar ekzekutimin - transferimin e 3,500,632.50 €, ka kryer veprime të kundërligjshme të cilat bien në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me

ekzekutimin/përmbarrimin e vendimeve administrative, gjyqësore, përfshirë edhe ato të arbitrazhit kur bie rasti në lidhje me fondet e Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim. Përmbarruesi privat në këtë rast ka pasur para vetes një mori aktesh juridike të cilat është i obliguar të i respektojë e të bazohet në këto akte për veprimet të cilat janë ndërmarrë, mirëpo konsiderojmë që qëllimshëm Përmbarruesi Privat ka shmangur nga zbatimi këto akte juridike. Aktet Juridike të cilat paraqesin detyrime për tu respektuar nga ana Përmbarruesit Privat janë: Udhëzimi juridik i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme me nr. C – IV - 14-1607 të dt. 15 tetor 2015, përmes së cilit është paraparë që "Pezullohet çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit/ që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë ec/he procedurat përmbarrimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare " dhe gjithashtu parashihet që "Procedurat e pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme". Zbatimi i këtij akti juridik është i obligueshëm jo vetëm për dhe gjykatat por edhe për të gjitha institucionet e tjera, duke i përfshirë bankat dhe përmbarruesit privat. Ekzekutimi në bazë të Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të datës 29 dhjetor 2022, është bërë jo vetëm në kundërshtim me Udhëzimin Juridik të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, C – IV- 15 - 1607 të datës 15 tetor 2015 por edhe në kundërshtim me nenin 10 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në, dhe Sqarimin e Gjykatës Kushtetuese me 111'. ref. 1010/11/nk të datës 23 maj 2011. Gjithashtu, në këtë rast Përmbarruesi Privat, ka shkelur prapë Ligjin Nr. 04/L-034 për AKP-në, duke nxjerr Urdhrit për bllokimin e llogarisë bankare të deri në shumën 8,383,282.01 €, duke e llogaritur kamatën në këtë rast në kundërshtim me Ligjin e AKP-së, konkretisht në kundërshtim me nenin 37 (Llogaritja dhe kompensimi i kërkesave) ku thuhet se: "Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të os tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore". Siç dëshmohet nga Vendimi i Arbitrazhit i datës 5 nëntor 2010 në bazë të të cilit kreditori, ka parashtruar kërkesën në likuidim, shuma themelore e cila është vendosur në vendim të arbitrazhit, është 4,118,737.83 € plus kamata. Në rastin konkret, Përmbarruesit Privat, e ka llogaritur kamatën në kundërshtim me Ligjin e AKP-së por është bazuar në të ashtuquajturën ekspertizën financiare të auditorit ligjor të datës 31 gusht 2022 në bazë të Urdhrit Përmbarrimor, P.nr.001/20 të datës 3 janar 2020.

Në këtë rast sipas palës ankuese, i është shkaktuar dëm i drejtëpërdrejtë, kreditorëve të dhe kësajsoj fondi i është dëmtuar në atë masë sa që kërkesat e kreditorëve të tjerë të, të përcaktuar në kategori më të larta të prioritetit ose në kategori të njëjtë do të mbeten të pa përmbushura në rast se mjetet e tërhequra nga llogaria bankare e, nuk do të kthehen. ka si konfirmim, e mailin e datës 21 tetor 2015, ku Oda e Përmbarruesve Privat, i ka njoftuar të gjithë përmbarruesit privat se sipas Bordit Ekzekutiv të Përmbarruesve Privat, përmbarruesit privat, duhet t'i përmbahen Udhëzimit nr. C-IV-15-1607 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ka shtuar edhe se mund të shihni në këtë e mail se edhe Përmbarruesi Privat, është njoftuar si të gjithë përmbarruesit, se duhet t'i përmbahen këtij udhëzimi të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Më 23 tetor 2015, i ka njoftuar të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave lidhur me Udhëzimin nr. C-IV-15-1607 dhe po ashtu më 11 nëntor 2015, e ka njoftuar Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me Udhëzimin nr. C-IV-15-1607. Në bazë të ligjit të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në, pagesat e kreditorëve të cilat kanë vendime të aprovuara nga ana e Autoritetit të Likuidimit apo vendime gjyqësore të plotfuqishme që aprovjnë ankesat e tyre ndaj vendimeve refuzuese të Autoritetit të Likuidimit, bëhet përmes aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të të raporteve të Shpërndarjes për kreditorët në proporcion me atë se sa fonde ka. Për më tepër për, është aprovuar Raporti i Shpërndarjes së Përkohshme të

pjesshme më datë 28 gusht 2020, dhe kreditorëve të cilët kishin kërkesat e tyre të aprovuara, iu është shpërndarë 69% e shumës së aprovuar ndërsa për kreditorët tjerë të cilët kishin ankesa pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, është rezervuar 69% e shumës të cilën ata pretendojnë dhe në këtë listë të ankesave është i përfshirë edhe kreditori,

. Andaj, kreditori, është dashur të pres që të vendoset mbi ankesën e tyre ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT 138-0552, dhe të shqyrtohet lënda C – IV – 14 - 0446 në të gjitha instancat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe këtë gjë rrjedhimisht është dashur t'a ketë parasysh edhe Përmbartuesi Privat, nga pasi që për këtë çështje veçse e kemi njoftuar. konsideron se ky veprim i këtij Përmbartuesi Privat për përmbartimin ndaj fondeve në mirëbesim të (në likuidim) dhe vazhdimi i një praktike të tillë, do të vinte në rrezik procesin e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, fondin në mirëbesim si dhe buxhetin e Republikës së Kosovës, kur dihet fakti se ekzistojnë disa raste të personave fizik — juridik të cilët kanë pretendime kreditorë ndaj fondit të mirëbesimit kërkon nga Mistria e Drejtësisë përkatësisht Departamenti për Profesione të Lira, që në bazë të Udhëzimit Administrativ, MD-NR.09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, që ndaj Përmbartuesit privat z. të iniciohet procedura e shqiptimit të masës disiplinore pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje flagrante të dispozitave ligjore në fuqi dhe të akteve juridike të cituara si më lartë.

Raporti për fillimin e Procedurës Disiplinore nga Ministria e Drejtësisë (MD).

Ministria e Drejtësisë (MD), në bazë të kërkesës së dt.10.01.2023 të palës ankuese, ne seli në , me dt.10.01.2023, ka hartuar Raportin për fillimin e procedurës disiplinore për lëndën, P.nr.01/20 e në të cilën ne seli në , e në të cilin ka cekur se ky përmbartues privat dhe si organ i përmbartimit, me rastin e nxjerrjes së Urdhrit për Transfer me nr.P.nr.0001/20 të dt.29.12.2022 e të cilin, Urdhër, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, e ka aprovuar dhe si të tillë e ka lejuar ekzekutimin – transferimin e 3,5000.632.50 eurove, ka kryer veprime kundërligjore të cilat bijnë në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me ekzekutimin/përmbartimin e vendimeve administrative, gjyqësore, përfshirë edhe ato të arbitrazhit kur bie rasti në lidhje me Fondet e Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim. Përmbartuesi privat në këtë rast ka pasur para vetes një mori aktesh juridike të cilat është i obliguar të i respektoj dhe të bazohet në këto fakte për veprime të cilat janë ndërmarrë mirëpo ka konsideruar se ai qëllimshëm ka shmangur nga zbatimi këto akte juridike dhe se këto akte juridike, janë : Udhëzimi, C – IV – 15 – 1607 i dt.15 tetor 2015 i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGJSK). Mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese e dt.06.01.2023, nuk ishte ushtruar në përputhje me nenin 3 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ MD-nr.09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, me dt.10.01.2023 përmes postës elektronike, nga pala ankuese, është kërkuar nga paraqitësi i kërkesës t'a bëjë plotësimin e ankesës në përputhje me dispozitën e lartcekur dhese me dt.10.01.2023 përmes postës elektronike, Departamenti për Profesione të Lira Divizionipër Noterinë dhe Përmbartimin Privat, me datën 10.01.2023 nga Drejtor Menaxhues Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka pranuar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore kundër Përmbartuesit Privat, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me lëndën përmbartimore P.nr.001/2020.

Sipas pretendimeve të parashtruara në kërkesë, përmbartuesi privat përmes ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore me rastin e nxjerrjes së Urdhrit për Transfer, P.nr.001/20 e të cilin Banka Qendrore, e ka aprovuar si të tillë dhe e ka lejuar ekzekutimin –

transferimin e 3,500/63250 €, ka kryer veprime që bien në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore në lidhje me ekzekutimin/përmbarrimin e vendimeve administrative, gjyqësore, përfshirë edhe ato të arbitrazhit kur bie rasti në lidhje me fondet e ndërmarrjeve shoqërore në likuidim. Sipas pretendimeve të palës përmbarruesi privat qëllimisht ka shmangur zbatimin e akteve juridike. Gjithmonë sipas pretendimeve të parashtruara në kërkesë Përmbarruesi Privat, ka bërë shkelje të dispozitave të Udhëzimit Juridik të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, C-IV-15-167 të dt. 15.10.2015, shkelje të nenit 37 Ligjit, nr.04/L-034 për AKP-në dhe shkeljen e nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/ L-034 për AKP-në dhe se ka theksuar se mbështetur në faktet e lartcekurat paraqitësi i kërkesës, kërkon që në përputhje me nenin 365, 366, 367 dhe 368 të Ligjit 04/ L-139 për procedurën disiplinore, të iniciohet procedurë disiplinore ndaj përmbarruesit privat e ndaj të njëjtit të shqiptohet masë disiplinore pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me Shkelje flagrante të dispozita ligjore në fuqi dhe akteve të cituara si më lartë. Andaj, Departamenti për Profesionet të Lira pas kompletimit të lëndës dhe mbështetur në faktet e lartcekura propozon që Komisioni Disiplinor në përputhje me nenin 373 të ligjit për Procedurën Përmbarrimore, të ndërmarr veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë.

Pretendimet e Përmbarruesit Privat.

Përmbarruesi Privat, nga pas njoftimit të dt.10.01.2023 të Komisionit Disiplinor të bërë në adresë të tij për fillimin e procedurës disiplinore, brenda afatit prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij njoftimi, nuk është deklaruar me shkrim në adresën e Komisionit Disiplinor për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tij si përmbarruesi privat dhe organ i përmbarrimit por i njëjti është përmes av. nga më gjerësisht është deklaruar me shkrim me Parashtrësën e dt.16.02.2023 për deklarim me shkrim për seancën dëgjimore dhe se në këtë deklarim i njëjti ka vënë në pah historikun procedural të rastit para inicimit të procedurës disiplinore pra prej paraqitjes së propozimit për përmbarrim të dt.03.01.2020 të palës kreditore, lejimit të përmbarrimit me Urdhrin për përmbarrim, P.nr.001/2020, e deri te nxjerrja e aktvendimit, AC- I – 22 - 0245 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar.

Komisioni Disiplinor për Përmbarrues Privat, me dt.16.02.2023, ka mbajtur seancën dëgjimore me palët në procedurë dhe se në këtë seancë, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë (MD), si dhe përfaqësuesi i palës ankuese, ie seli në ka deklaruar se mbeten pranë propozimit për inicimin e procedurës disiplinore si dhe në Raportin e MD-së së dt.10.01.2023 për fillimin e procedurës disiplinore për Përmbarruesin Privat,

nga

Përfaqësuesi i palës ankuese, deklaroj se mbeti pranë kërkesës së dt.10.01.2023 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj dhe në pika të shkurtra e prezantoj raportin e propozimin për fillimin e procedurës disiplinore, DPL nr.01/2023.

Përmbarruesi Privat, nga deklaroj se nuk ndihet përgjegjës për asnjë shkelje disiplinore nga debitorët meqenë se edhe vet në propozimin e fillimit të procedurës disiplinore nuk e cek asnjë dispozite ku përmbarruesi ka bërë ndonjë tejkallim apo ndonjë nen siç parashihet në ligj, por e thekson vetëm shkelje flagrante që në ligj nuk di a ekzistojnë shprehje më të rënda.

Përfaqësuesi i palës Ankuese, deklaroj se qëndrojnë të gjitha argumentet ligjore të cekura në kërkesën për inicim e procedurës disiplinore mirëpo ka theksuar se dëshiron

që t'a njoftoj komisioni ne lidhje me urdhrin për ndalim të pjesshme afatgjatë të aseteve me numër PPPS.nr.1/2023, i cili është lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, përmes të cilit është aprovuar kërkesa për urdhër ndalues të pjesshëm afatgjatë të aseteve kërkesë kjo e Prokurorisë Speciale te Republikës së Kosovës, në mesin e palëve të përfshira ne këtë urdhër e për të cilin është bere ndalimi i pjesshëm afatgjate i aseteve nga përmbaruesi privat .

Gjithashtu një shkelje tjetër e cila nuk është përmendur ne kërkesën e iniciuar është shkelja e nenit 37 paragrafi 3 te ligjit te AKP-ës sepse përmbaruesi me lëshimin e urdhrin për transfer te datës 29 dhjetor 2022, ka kërkuar që të bëhet bllokimi i mjeteve duke përfshirë edhe kamatën e cila arrin po thuajse 100 përqind të shumës bazë e qe është në kundërshtim te hapur me nenin e lartcekur për arsye se ky nene parasheh se të gjitha kërkesat ndaj ndërmarrjes mund te përfshin kamat në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës se vendimit për likuidim me kusht që kjo kamatë të mos tejkaloj 10 përqindshin e shumës themelore. Ka shtuar se urdhri i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë i datës 3 shkurt 2023, është nxjerr duke u bazuar në faktin që është shkelur Udhëzimi juridik i Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme dhe neni 10 i ligjit te AKP-së, dhe se ndërmarrja është ne likuidim.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesja e MD-së, deklaroj në mes tjerash se nga Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, , me dt.06.01.2023, ka pranuar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore kundër Përmbaruesit Privat : i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me lëndën përmbarimore. P.nr.001/20, Meqenëse kërkesa nuk ishte ushtruar në përputhje me nenin 3 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativë MD-nr.09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat me datë 10.01.2023 përmes postes elektronike kemi kërkuar nga paraqitësi i kërkesës plotësimin e ankesës në përputhje me dispozitën e lartcekur. Me datë 10.01.2023, përmes postës elektronike nga paraqitësi i kërkesës kemi pranuar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat se sipas pretendimeve të parashtruara në kërkesë, përmbaruesi privat përmes ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore me rastin e nxjerrjes së urdhrin për transfer me nr. P.nr.001/20, e të cilin Banka Qendrore e ka aprovuar dhe si të tillë e ka lejuar ekzekutimin transferimin e 3,500,632.50 Euro, ka kryer veprime që bien në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore, përfshirë edhe ato të arbitrazhit kur bie rasti në lidhje me fondet e ndërmarrjeve shoqërore në likuidim. Sipas pretendimeve të palës përmbaruesi privat qëllimisht ka shmangur zbatimin e akteve juridike, e ka shtuar se gjithmonë sipas pretendimeve të parashtruara në kërkesë Përmbaruesi Privat ka bërë shkelje të dispozitave të Udhëzimit Juridik të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme C-IV-15-167 të datës 15.10.2015, shkelje të nenit 37 Ligji nr.04/L-034 për AKP-në dhe shkelje e nenit 10 të shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në. Mbështetur në faktet e lartcekurat paraqitësi i kërkesës, kërkon që në përputhje me nenin 365, 366, 367 dhe 368 të Ligjit 04/L-139 për procedurën disiplinore, të iniciohet procedurë disiplinore ndaj përmbaruesit privat dhe ndaj të njëjtit të shqiptohet masë disiplinore pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje flagrante të dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve të cituara si më lartë. Andaj, Departamenti për Profesione të Lira pas kompletimit të lëndës dhe mbështetur në faktet e lartcekura propozon që Komisioni Disiplinor në Përputhje me nenin 373 të ligjit për procedurën përmbarimore, të ndërmarr veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë.

Në seancën dëgjimore, av. nga i autorizuar i përmbaruesit privat, deklaroj se e paraqet me shkrim deklarin lidhur me çështjen disiplinore në fjalë dhe se në pika të shkurtra e bëri elaborimin e këtij deklarimi me shkrim dhe se në këtë deklarim me shkrim, ka dhënë sqarime në 3 (tri) pretendimet e palës ankuese siç janë: pretendimin e parë, se pala ankuese, nuk e ka pranuar ankesën e kreditorit ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me pezullimin e procedurës përmbarimore dhe kinse në këtë mënyrë iu është

pamundësuar që t'i paraqes argumentet e tij, dhe se lidhur me këtë pretendim të palës ankuese, ka theksuar se sipas fletërdërgesës për dorëzim personal. PPP.nr.90/20, pala ankuese e ka pranuar ankesën e kreditor të dt.14.06.2021, se për pretendimin e dytë se Përmbauesi Privat, e ka llogaritur kamatën në kundërshtim me nenin 37 të Ligjit për AKP-në, ka theksuar se llogaritjen e kamatës nuk e ka bërë Përmbauesi privat por e ka bërë eksperti financiar si dhe se kamata ka qenë e përcaktuar në dokumentin përmbaues përkatësisht në vendimin e arbitrazhit pasi që ky vendim është vendosur në bazë të ligjit francez (the lex arbitrii) si dhe se në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi të arbitrazhit, është urdhëruar që "... norma e interesit e zbatueshme do të jetë ajo e caktuar për vitin përkatës me Dekret nga Qeveria e Francës" dhe se pretendimin e tretë të palës ankuese se Përmbauesi Privat përmes nxjerrjes së Urdhrit për transfer, P.nr.001/220, ka kryer veprime të kundërligjshme të cilat bien në kundërshtim të plotë me aktet juridike dhe praktikën gjyqësore, ka sqaruar se ky pretendim është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe se pretendimi i palës ankuese se ekzekutimi në bazë të urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022, është bërë në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit për AKP-në dhe Udhëzimit me nr. C – IV – 14 – 1607, është i pabazuar sepse të gjitha këto pretendime janë trajtuar nga Gjykata Komerciale në Prishtinë, Dhoma e Shkallës së Dytë përmes aktvendimit të saj, Kom.Dh.Shk.II.nr. 1340/22 të dt.23.06.2020 e duke konsideruar se Përmbauesi privat, nuk ka të drejtë e as mundësi që tani t'i ri trajtoj çështjet të cilat janë trajtuar dhe janë vendosur nga Gjykata e qarta më tepër Përmbauesi privat, nuk mund të veprojë në kundërshtim me Vendimet e Gjykatës. Po ashtu në këtë deklaram me shkrim i autorizuari i përmbauesit privat ka referuar edhe në çështjen e merës së vendosjes nga Gjykata Komerciale se me aktvendimin e lartë cekur të saj, kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar, "res iudicata" si dhe për çështjet tjera që kanë të bëjnë me vendimmarrjen nga Gjykata Komerciale në aktvendimin e saj por edhe çështjet tjera rreth mënyrës së veprimit të një përmbauesi privat në procedurë përmbaimore e kur dokument përmbaues (titull ekzekutiv), është një vendim i arbitrazhit si në rastin konkret e me propozimin që Komisioni Disiplinor të nxjerr vendim e me të cilin, refuzohet raporti i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Profesionet e Lira – Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat., DPL.nr.01/2023 i dt.10.01.2023 dhe propozimi për iniciimin e procedurës disiplinore i paraqitur nga pala ankuese,

ne seli në me të cilin ka kërkuar që Përmbauesit Privat, si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për territorin e Gjykatës Themelore në t'i shqiptohet masa disiplinore, shkarkim nga detyra, si i pabazuar si dhe Përmbauesi privat, si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për territorin e Gjykatës Themelore në nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduara nga propozuesi – pala ankuese, i, gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbaimore, P.nr.001/2020.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i palës ankuese, . deklaroi se e njoftojmë komisionin që Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, nuk e ka anuluar ose refuzuar në tërësi propozimin për masë të përkohshme nga ana e por atë e ka kthyer në rishqyrtim në shkallë të parë. Gjithashtu kreditori me vendimin e Arbitrazhit, është paraqitur në procedurë të likuidimit, se kreditori në procedurë të likuidimit është paraqitur me vendimin e Arbitrazhit me të cilin janë duke u thirrur, si rrjedhojë e vendimit të Arbitrazhit duhet dhe zbatohen në procedurë të likuidimit sipas rregullativës ligjore të lerisa edhe përfaqësuesi tjetër i palës ankuese deklaroi se përmendja e për çështjen e kthimit në ri shqyrtim përfaqësuesi i autorizuar i përmbauesit, lëndë në lidhje me masën e sigurimit me numër, AC-I-22-0542 të dt.19 shtator 2022, e cila është ende duke u shqyrtuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Në seancën dëgjimore, i autorizuari i përmbauesit privat, nga
, duke u ndërliður me deklarimet e përfaqësuesit të deklaroi se liður me pretendimin e zhvillimit të procedurës penale duhet te theksoj se asnjë person nuk mund te jete fajtor është maksima juridike deri sa gjykata me vendim te plotfuqishëm ta shpall fajtor dhe krejt në fund aktvendimi i Dhomës se Posaçme te Gjykatës Supreme AC-I-2145/42, është nxjerr me datë 29 nëntor 2022, me të cilin ka anuluar aktvendimin e Gjykatës së Shkalles së Parë liður me kërkesën për shtyrjen e procedurës përmbaimore në ndërkohe asnjë gjykatë e asnjë organ tjetër edhe pse kanë kaluar ca muaj nuk ka nxjerr ndonjë vendim tjetër me te cilin do ta ndalonte përmbaimin e një vendim te tillë, nuk ka nxjerr as gjer me date 27.12.22, kur përmbauesi ka nxjerr urdhrin për bllokimin e mjeteve e as me datë 29.12.22, kur ka nxjerr urdhrin tjetër për transfer qe do te thotë veprimi i përmbauesit privat nuk ka pas kurrfarë pengese ligjore për tu zbatuar.

Në seancën dëgjimore, po ashtu edhe nga i autorizuari tjetër i përmbauesit privat, nga deklaroi se liður me pretendimet e palës propozues e në këtë rast se Gjykata Themelore Prishtine Departamenti Special për lëndën me numër, PPPS.nr.1/23, te datës 3 shkurt 23, se për këtë rast tani më nuk kemi bllokim të llogarive bankare të asnjërës llogari të përmbauesi privat mirëpo është aprovuar kundërshtimi dhe kërkesa e përmbauesit privat për lirimin e te njëjtave, andaj nga propozuesi i saj po tentohet që ti jepet konotacion tjetër te asaj nga çka është e vërteta për këtë komisionit i ofrojmë ku dëshmojmë të njëjtën për më tepër referimi i palës se kemi një procedurë penale e njëjta nuk ka asnjë ndikim për faktin se është ende në fazat fillestare dhe nuk është vërtetuar asnjë pretendim në këtë fazë të procedurës andaj konsiderojmë se këto pretendime nuk kanë mbështetje ligjore.

Në seancën dëgjimore të dt.16.02.2023, pasi që Komisioni, ka dëgjuar palët në procedurë, ka bërë edhe adminnistimin dhe shqyrtimin e të të gjitha provave të lëndës e përmes leximit të tyre e siç janë : komunikimi me email i dt.3.11.2015 nga për urdhrin për lejimin e përmbaimit P.nr.001/2020 i përmbauesit privat, nga . vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC nr.15386/FM) dt.5 nëntor 2010, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.384/2014, date 9.07.2014, prapësimi i debitorës – i datës 14.01.2020, i ushtruar ndaj Urdhrit përmbaimit, P.nr.001.20120, date 3.01.2020, përgjigja ne prapësim e kreditores e datës 23.01.2020, mendimi juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës numër 388/2014 i datës 16.10.2014, leximi i listës shoqëruese regjistruar i dërgesave të regjistruara të zyrës postare në Mitrovicë i datës 14.01.2020, konkluzioni i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.90/20 i datës 23.06.2020, kërkesa për vazhdimin e procedurës se pezulluar e kreditores e datës 06.04.2021, komunikimi me email i datës 30.03.2021, i përmbauesit me lidhur me çështjen e autorizimi të skanuar, kopja e shkresës së likuidimit e , se bashku me kopja e njoftimit për likuidim të , me numër te regjistrin , se bashku me raportin e mbledhjes se drejtoveve komunikatë për media, datës 28.01.2020, kopja e konkluzionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.90/20 të dt.19.04.2021, sa i përket deklarimit e vazhdimit te procedurës, parashtrësja e AKP-së e datës 27.04.2021 në lidhje me konkluzionin e Gjykatës Themelore, P.nr.90/20, konkluzioni i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.90/20 datës 31.05.2021, kopja e ankesës së kreditorit e ushtruar kundër konkluzionit, P.nr.90/20 e dt.31.05.2021, kopja e shpalljes zyrtare për spin of 4.2 nga i e dt.14.06.2021, kopja e njoftimit te e dt.14.06.2021 me listën e bashkangjitur, se bashku me pjesën e te hyrave nga privatizimi në komunikim në gjuhës angleze kur është bere shitja dhe komunikata për media e e datës 26.08.2021, kopja e kërkesës se kreditores e datës 26.07.2022, drejtuar kryetarit te Gjykatës Komerciale ne Prishtine për trajtimin urgjent të ankesës se kreditores, kopja e kërkesës për transfer të lëndës PPP.90/20, e kreditores të dërguar ne adresë të përmbauesit, kopja e

aktvendimit te Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Shk.II.nr.130/22 i datës 23.08.2022, ekspertiza financiare për kamatën e 31 gusht 2022, eksperti auditor ligjor, komunikimet me email te datës 05.09.2022, deri me 12.09.2022, kopja e kërkesës për marrjen e veprimeve përmbarimore numër P.nr.001/2020, e drejtuar përmbaruesit privat nga autorizuar i kreditorit e dt.05.09.2022, kopja e kërkesës për vazhdimin e kërkesës për vazhdimin e procedurës përmbarimore e kreditores e datës 08.09.2022 për lëndën, P.nr.001/2020, kopja e komunikimit me email e 19.09.2022, ne lidhje me lëndën pranë Dhomës së Posaçme, C – IV - 14 - 0446, aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, C – IV - 14 - 00446 i dt.19.09.2022, që ka të bëjë me masën e sigurisë, kopja e parashtrësës se , në lidhje me lëndën, AC-I-22-0542, aktvendimi i Kolegjit te Apelit te Dhomës së Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës, AC – I – 22 - 0542, kopja e aktvendimit te Gjykatës Supreme te Kosovës, Rev.E.nr. 58/22, datës 14.12.2022, Urdhri për bllokim, P.nr.001/20 i përmbaruesit privat i datës 27.12.2022, Urdhri për bllokim, P.nr.001.2020, datës 27.12.2022, kopja e përgjigjes së BQK-së drejtuar përmbaruesit privat në lidhje me urdhrin për bllokim, P.nr.001/20 të dt.27.12.2022, kopja e komunikimit me email e dt.22.12.2022, e kryer nga të autorizuarit të kreditorës me përmbaruesin Urdhri për ndalin të pjesshëm afatgjatë të aseteve PPPS.nr.1/23 i dt.3.02.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Urdhri për transfer i dt.29.12.2022, me numër, P.nr.001/2022, si dhe shkresa e së e datës 30.12.2022 lidhur me Urdhrin për transfer, P.nr. 001.2022 të datës 29.12.2022, Urdhri Ndalues për Ngrirje të Përkohshme të Aseteve, PPPS.nr.1/23 i dt.06.01.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Urdhri për ndalin të pjesshëm afatgjatë të aseteve PPPS.nr.1/23 i dt.3.02.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pas përfundimit të fazës së procedimit të provave, Komisioni, pasi i ka ftuar palët në procedurë që të paraqesin fjalën përfundimtare në këtë çështje juridike disiplinore, përfaqësuesi i , në fjalën e tij përfundimtare, deklaroj se kërkon që të deklarohet me shkrim në provat dhe deklaratën e dorëzuar në seancën dëgjimore por edhe fjalën përfundimtare me e deklaruar me shkrim derisa Përmbaruesi Privat, deklaroj se në lidhje me deklarinimin e përfaqësuesit të në lidhje me mundësinë që të deklarohen me shkrim në lidhje me provat e administruara si dhe paraqitjen e fjalës përfundimtare me shkrim, deklaroj se e kundërshtojnë propozimin e thirrur në parim nga shkaku se të gjitha provat e propozuara nga ana e tyre, janë prova që janë pra kanë qenë në dispozicion edhe të palës kundërshtare gjatë tërë zhvillimit të kësaj procedurë, gjithsesi edhe nëse komisioni e aprovon këtë, shtyrja të jetë sa e më e shkurtër.

Komisioni Disiplinor për Përmbaruesit Privat, lidhur me propozimin për deklarim me shkrim të palës ankuese, , si dhe dhënies se fjalës përfundimtare me shkrim të saj, pasi që u tërhoq për të vendos për këtë propozim, mori aktvendim e me të cilin, vendosi që të aprovoj këtë propozim të palës ankuese, AKP-së dhe të njëjtës, ia mundësua që në afatin prej 3 ditëve të paraqes me shkrim përgjigjen e saj në deklarinimin me shkrim të bërë në seancën dëgjimore të av. nga i autorizuar i përmbaruesit privat, nga si dhe t'a paraqes me shkrim fjalën përfundimtare në këtë çështje juridike disiplinore dhe se Komisioni Disiplinor, vendosi që të bëjë shtyrjen e vendimmarrjes lidhur me objektin lëndor pasi që palëve në procedurë, iu lejua mundësia që të paraqesin me shkrim fjalën përfundimtare në afatin prej 3 (tre) ditëve.

Pala ankuese, me seli në me dt.20.02.2023, në deklarinimin me shkrim të dorëzuar në seancën dëgjimore të dt.16.02.2023 nga av. nga i autorizuar i përmbaruesit privat, nga , duke respektuar afatin e dhënë prej 3 (tre) ditëve përmes komunikimit me e mail, me dt.20.2.2023, ka paraqitur Përgjigje me shkrim e me sqarimin në lidhje me historiatin procedural të rastit para inicimit të procedurës disiplinore e në të cilën në mes tjerash ka theksuar se, pala ndaj së cilës është inicuar procedura disiplinore, në këtë pjesë i shmanget në tërësi çështjes së procedurës së likuidimit të

e cila është çështja thelbësore në këtë rast, se me vendimin e _____ ka vendosur në procedurë të likuidimit më datë 21 dhjetor 2010 dhe si rrjedhojë.

" si kreditor, kishte parashtruar kërkesë në likuidim, të cilën e kishte bazuar në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Odës Ndërkombëtare në Paris, nr.15386/FM të datës 05 Nëntor 2010. Me faktin që kreditori kishte parashtruar kërkesë në likuidim duke e bazuar kërkesën në vendimin e lartë cekur të Arbitrazhit, nënkupton që ka kuptuar drejtë rregullativën ligjore dhe ka kërkuar që vendimi i Arbitrazhit të përmbushet në procedurën e likuidimit, ashtu edhe siç duhet të jetë si dhe sërish i ka përsëritur të thënat nga kërkesa e dt.06.01.2023 dhe ajo e dt.10.01.2023 për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbartuesit privat _____ nga _____ dhe provat e bashkangjitura këtyre kërkesave.

Përfaqësuesi i palës ankuese, _____ në fjalën e tij përfundimtare të paraqitur me shkrim, në mes tjerash Komisionit Disiplinor, i ka propozuar që : të refuzohet ankesa e Përmbartuesit Privat, _____ ndaj vendimit, Nr. 4/2023 i datës 10.01.2023 të Ministrisë së Drejtësisë dhe Kërkesës së _____ për Iniciimin e Procedurës Disiplinore, të aprovohet kërkesa e _____ për iniciimin e procedurës disiplinore, të vërtetohet që Përmbartuesi Privat _____, është përgjegjës për shkelje disiplinore, duke vepruar në kundërshtim me nenet 365 dhe 367 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore; dhe të njëjtit, t'i shqiptohet masa disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, _____ në pajtim me nenin 368 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, duke marrë për bazë peshën dhe pasojat e shkeljes, dëmin e shkaktuar dhe shkallën e përgjegjësisë si dhe ia ka bashkangjitur edhe disa prova të tjera.

Përmbartuesi privat, lidhur me përgjigjjen me shkrim në deklarin e tij me shkrim të dt.16.02.2023, dhe paraqitjes së fjalës përfundimtare me shkrim të palës ankuese, me dt.21.03.2023, ka bërë vërejtje me në të cilën në mes tjerash ka theksuar se _____ përmes fjalës përfundimtare me shkrim, ka paraqitur prova të reja pra disa vendime të vetëm të shkallës së parë për disa raste të tjera e të cilat nuk janë paraqitur asnjëherë më parë as përmes propozimit për iniciimin e procedurës disiplinore e as në seancën dëgjimore të datës 16.02.2023, si dhe se në këtë vërejtje, është përqënduar edhe në aktvendimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Shk.II.nr.130/22 i datës 23.08.2022, si dhe lidhur me çështjen e kalkulimit të kamatës e duke konsideruar se veprimet e tij si përmbartues privat, nuk përbëjnë anjërën nga shkeljet e pretenduara nga propozuesi apo çfardo shkelje të parapara me LPP.

Po ashtu edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti Ligjor, me dt.22.02.2023, përmes e mailit, i është drejtuar Komisionit Disiplinor e në të cilën ka sqaruar për çështjen e dërgimit të vërejtjeve të Përmbartuesit privat, _____ përkitazi me çështjen e përgjigjjes me shkrim në deklarin me shkrim të dt.16.02.2023 të av. _____ nga _____ i autorizuar i përmbartuesit privat, dhe në fjalën përfundimtare me shkrim të palës ankuese, _____ dhe deklarimeve të tjera në këtë çështje disiplinore e me kërkesën që parashtrua e përmbartuesit privat të mos merret parasysh nga ana e Komisionit Disiplinor.

Baza ligjore e shkeljes disiplinore.

Shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin e Procedurës Përmbartimore (LPP), janë si në vijim: "nëse përmbartuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj; 1.38 1.2. nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbartuesi privat nuk i përmbahet ligjit; 1.3. nëse përmbartuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij; 1.4. nëse përmbartuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr; 1.5. nëse përmbartuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim; 1.6. nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e

mbajtjes së sekretit zyrtar; 1.7. nëse përmbaruesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë; 1.8. nëse përmbaruesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional; 1.9. nëse përmbaruesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbarimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull; 1.10. shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera; 1.11. nëse përmbaruesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë". Në këtë rast siç shihet nga konstatimet dhe vlerësimet e bëra si më lartë, Komisioni Disiplinor, erdhi në përfundim se përmbaruesi privat, _____ nga _____, dhe organ përmbarues ka bërë shkelje disiplinore nga nenin 367 paragrafi 1 nën paragrafi 2 i LPP-së, i cili përcakton se: "Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit", derisa për çështjen e masave disiplinore bëhet fjalë në nenin 368 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP) e në të cilin, thuhet se: "Masat disiplinore për shkeljet disiplinore janë si në vijim: 1.1. vërejtja; 1.2. vërejtja publike; 1.3. gjoba në të holla nga pesqind (500) deri tremijë (3000) Euro; 1.4. ndalimi i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit; 1.5. shkarkimi nga detyra". Në rastin konkret, si shkelje të ligjit dhe se Përmbaruesi privat, _____ nga _____ dhe si organi i përmbarimit, nuk i përmbajtur një ligji, është mos respektimi i nenit 10 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në që bënë fjalë për Pezullimi i veprimeve e në të cilin, thuhet se: "Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim. 2. Veprimet, procedurat apo aktet e tilla të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të likuidimit apo të Gjykatës ..". Në rastin konkret, Përmbaruesi privat, _____ nga _____ dhe në cilësi të organit të përmbarimit, nuk iu ka përmbajtur pra nenit 10 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në lidhur me pezullimin e procedurës përmbarimore në lëndën, P.nr.001/20 dhe se kjo situatë juridike, është e konkretizuar për t'u respektuar nga të gjitha institucionet përfshirë edhe Përmbaruesin Privat në fjalë, si organ i përmbarimit edhe me Udhëzimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK, nr. C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015 e që ka të bëjë me pezullimin e të gjitha procedurave gjyqësore, administrative apo të arbitrazhit por përkundër kësaj, ka ndërmarr veprime përmbarimore siç u vlerësua më lartë, dhe atë duke e nxjerr, Urdhrit, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 për transferimin e mieteve monetare në shumën e lartë cekur e të cilat i ka pasur në llogarinë e vet, _____ me seli në _____ dhe të njëjta mjete janë transferuar në llogarinë e Përmbaruesit privat në fjalë, e më pas mjetet monetare të lartë cekura, janë transferuar në xhirollogarinë gjegjëse bankare të palës kreditore, _____ si dhe të personave të tretë.

Çështjet kontestuese dhe jo kontestuese në çështjen juridike disiplinore.

Në këtë çështje juridike disiplinore midis palëve në procedurë, si kontestues është paraqitur çështja e veprimeve të ndërmarra nga përmbaruesi privat në çështjen përmbarimore, P.nr.001/2020 dhe atë nxjerrja e Urdhrit, Përmbaruesi Privat, _____ nga _____ P.nr.001/2022 i dt.29.12.2022, për transferin të mjeteve gjegjëse monetare në shumën 3,500,632.50 €, pas nxjerrjes së aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Shk.II.nr.130/22 i datës 23.08.2022, si dhe çështja e kalkulimit të kamatës, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor në të holla në shumën prej 4,118,737.83 € e së bashku kamatën e kalkuluar, dhe atë në bazë të Vendimit të Arbitrazhit, nr.15386/FM të dt.05 nëntor 2010 të Odës Komerciale Ndërkombëtare të Parisit, dhe procedimit të mëtejshëm në çështjen juridike përmbarimore, P.nr.001/2020, se a paraqesin shkelje disiplinore.

Por se midis palëve dhe Komisionit Disiplinor, nuk është kontestuese çështja se Përmbartuesi Privat, nga e ka lejuar propozimin për përmbartim të dt.03.01.20220 të bërë nga kreditorja e përmbartimit, dhe atë me urdhrin e tij, P.nr.001/2020 të dt.03.01.2020 dhe atë në bazë të dokumentit të përmbartimit – Vendimit të Arbitrazhit, nr.15386/FM të dt.05 nëntor 2010 të Odës Komerciale Ndërkombëtare të Parisit i njohur dhe i shpallur i ekzekutueshëm me Aktvendimin, I.C.nr.384/2014 të dt.09.07.2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, se nala ankuese, si menaxhuese dhe përfaqësuese e me seli në ka bërë kërkesë te Ministria e Drejtësisë me seli në Prishtinë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, nga, si organ përmbartues dhe se Ministria e Drejtësisë (MD) me seli në Prishtinë, me dt.10.10.2023, ka iniciuar këtë procedurë disiplinore.

Historiati procedural para iniciimit të procedurës disiplinore dhe pas iniciimit të procedurës disiplinore.

Përmbartuesi, privat, nga në cilësi të Përmbartuesit privat për territorin e Gykatës Themelore në është emëruar në vitin 2014 dhe atë me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë, Nr.288-2014 të dt.06.11.2014 (01 – 32/2 të dt.5.09.2014) ndërsa ushtrimin e veprimtarisë përmbartuese, i njëjti, e ka filluar me datë 10.11.2014, dhe atë sipas vendimit të nxjerr nga Ministria e Drejtësisë, Nr.426/2014 të datës 06.11.2014 (Nr.01 - 3212/8 i dt.06.11.2014).

, (në likuidim) me vendimin e , ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.21 dhjetor 2010 dhe rrjedhimisht në përputhje me nenin 7 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L – 034, kreditorët kanë qenë të obliguar të parashtrorjnë kërkesat e tyre në likuidim brenda afatit ligjor, se në mesin e kreditorëve që kanë parashtruar kërkesë në likuidim është edhe me dt.26 nëntor 2013 e kërkesa e të cilit është trajtuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit dhe është nxjerr vendimi nr. MIT 138 - 0552 më datë 19 qershor 2013 përmes së cilit është refuzuar kërkesa kreditore e kreditorës, kërkesa e palës ishte e bazuar në vendimin e arbitrazhit të Odës Komerciale Ndërkombëtare të Parisit nr.15386/FM të datës 05 Nëntor 2010. Më datë 27 janar 2014 , ka parashtruar ankesë në Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) ndaj vendimit të AL-së, MIT 138-0552, e cila është e regjistruar me numër, C – IV – 14 - 0446 dhe DhPGJSK-ja, ende nuk ka nxjerrë ndonjë vendim në lidhje me këtë ankesë. Paralel me procedurën e paraparë ligjore për shqyrtimin e ankesës nga DHPGJ të kreditorit, ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit 111, MIT 138-0552, procedurë e paraparë me Ligjin Nr.04/L-034 për AKP-në dhe Ligjin Nr. 061-86 për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme, kreditori, kishte filluar procedurën e njohjes së vendimit të arbitrazhit ne Gjykatën Themelore dhe më datën 14 Korrik 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë — Departamenti për Çështje Ekonomike kishte nxjerrë aktvendimin, I.C.nr.384/2014 e përmes së cilit kishte njohur vendimin e arbitrazhit nr.15386/FM të Odës Komerciale Ndërkombëtare të Parisit.

Me datën 15 tetor 2015, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ka nxjerrë një Udhëzim me nr. C - IV -14 - 1607 e përmes së cilit ka paraparë që: "Pezullohet çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes si dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbartimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare " dhe gjithashtu parashihej që: "Procedurat e pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme". Sipas arsytimit ligjor të dhënë nga DHPGJSK-ja, në këtë Udhëzim, "zbatimi i këtij ligji (vërejtje: të AKP-së, është i obligueshëm jo vetëm për AKP-në dhe gjykatat por edhe për të gjitha institucionet e tjera, duke i përfshirë bankat si dhe përmbartuesit privat". Në bazë të

aktvendimit I.C.nr. 384/2014 Gjykatës Themelore në Prishtinë — Departamenti për Çështje Ekonomike, , ka paraqitur propozim për përmbarrim dhe si rrjedhojë Përmbarruesi Privat, më datën 03 janar 2020, ka nxjerrë Urdhrrin përmbarrimor, P.nr.001/2020, ndaj të cilit Autoriteti i Likuidimit, ka parashtruar prapësim më datë 16 janar 2020, dhe ka parashtruar argumentet e bazuara në ligj derisa me datë 23 qershor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka nxjerrë Konkluzion, P.nr.90/20 e përmes së cilit ka pezulluar procedurën në këtë çështje përmbarrimore për arsye se, Ndërmarrja është në likuidim, Kreditori, më datë 07 prill 2021, ka parashtruar kërkesë për lejimin e vazhdimin të procedurës përmbarrimore dhe ndaj kësaj kërkesë, Autoriteti i Likuidimit i , ka paraqitur parashtrësë ku i ka sqaruar dhe dëshmuar gjykatës se , është ende në procedurë të Likuidimit. Kërkesën në fjalë të kreditorës, , e ka refuzuar Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, dhe atë me Konkluzionin e datës 31 maj 2021 dhe e ka ri konfirmuar Konkluzionin e datës 23 qershor 2020, P.nr.90/20 dhe ka vendosur që procedura të mbetet e pezulluar në përputhje me Ligiin Nr.04/L - 034 për AKP-në dhe Udhëzimin nr.C-IV-14-1607 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme deri në përfundimin e procedurave të likuidimit të Kundër këtij konkluzioni, kreditori, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila i ka deleguar lëndët Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të cilën Autoriteti i Likuidimit/AKP nuk e ka pranuar asnjëherë nga Gjykata Komerciale në mënyrë që të paraqesë përgjigjjen në ankesë apo mbrojtjen dhe argumentet në lidhje me çështjen dhe si rrjedhojë Gjykata Komerciale e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë aktvendimin, e saj, Kom.Dh.Shk.II.nr. 1340/22 e me të cilin ka aprovuar ankesën e kreditorit dhe e ka lejuar vazhdimin e procedurës përmbarrimore sipas Urdhrit Përmbarrimor me nr. P.nr.001/2020 të datës 3 janar 2020 të Përmbarruesit Privat Më 12 shtator 2022, ka dorëzuar në cilësinë e propozuesit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, propozimin për caktimin e masës së sigurisë si dhe Urgjencë për shqyrtimin e lëndës në fjalë.

Më datë 19 shtator 2022, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin e saj, C - IV-14-0446, e ka aprovuar si të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë, e cila i ndalon organeve përmbarruese, ekzekutimin e Urdhrit përmbarrimor. Më datë 22 shtator 2022, kundërpropozuesi , ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0446 të datës 19 shtator 2022. Më datë 29 lentor 2022, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme ka nxjerrur aktvendim, AC - I - 22 - 0542 , përmes së cilit kërkesën për caktimin e masës së sigurisë e ka kthyer në rishqyrtim në shkallën e 1-rë të Dhomës së Posaçme. Vlen të ceket se Kolegji i Apelit, ka kthyer në ri shqyrtim tek shkalla e parë kërkesën për rishqyrtimin për masën e sigurisë vetëm për shkaqë procedurale, dhe në këtë formë ka obliguar shkallën e parë që të plotësojë kushtin procedural dhe të obligojë që të parashtrrojë padinë apo kundërpadinë pas urdhrit nga Gjykata e shkallës së parë. Për më tepër, Kolegji i Apelit me aktvendimin e tij, ka obliguar shkallën e 1-rë që të zgjidhë njëkohësisht në merita ankesën e paditësit (kundërpropozuesit në këtë rast) ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si dhe kërkesën e AKP-së për caktimin e masës së sigurisë.

Pas Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të pranuar nga dhe ekzekutuar më datë 29 dhjetor 2022, më datën 30 dhjetor 2022, ka paraqitur Kallëzim Penal ndaj disa zyrtarëve dhe kërkesë për Urdhër të Përkohshëm Ndalimi në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë e kësaj, Prokuroria Speciale ka nxjerrë, Urdhrrin, PPS.nr.1/23 të dt.04.01.2023, urdhër e përmes të cilit ndalohet tërheqja e mjeteve nga Llogaria Bankare e Përmbarruesit Privat si dhe po ashtu "ndalohet çdo aktivitet i mëtejme edhe i llogarisë bankare që ka pranuar fonde nga kjo llogari e lartcekur lidhur me përmbarrimin, P.nr.001/20 të datës 29 dhjetor 2022".

Pala ankuese, _____ përmes përfaqësuesit të tij, fillimisht me dt.06.01.2023 në adresë të Ministrës së Drejtësisë me seli në Prishtinë dhe Odës së Përmbauesve Privat, ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbauesit Privat, _____ dhe letrën njoftuese në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit për transfer me shenjën, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 nga llogaria e _____ (në likuidim) në Bankën Qendrore të Kosovës dhe se në këtë kërkesë, ka shprehur shqetësimin e saj në lidhje me ekzekutimin e pagesës nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) e cila e ka lejuar Urdhrin për transfer të përmbauesit privat, _____ në lëndën përmbaore, P.nr.01/2020 e sipas propozimit të kreditorit, _____ me numër të regjistrit të biznesit _____ e me adresë,

Sipas njoftimit nga BQK-ja e të pranuar me 30 dhjetor 2022, me datë 29 Dhjetor 2022 nga Banka Qendrore e Kosovës nga llogaria e _____ (në likuidim) nën administrimin e _____ janë transferuar 3,500,632.50 €, në llogarinë e përmbauesit privat,

Pala ankuese më pas me dt.10.01.2023, pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë (MD), e ka bërë plotësimin e kërkesës së saj për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbauesit privat në fjalë.

Konstatimet e Komisionit Disiplinor për Përmbaues Privat lidhur me shkeljen disiplinore nga përmbauesi privat dhe vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor për Përmbaues Privat, me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbauesi privat, ka kryer shkelje disiplinore, për arsye në vijim:

Komisioni, vlerëson se shkelja disiplinore e Përmbauesit privat, _____ nga _____ emëruar si Përmbaues privat për territorin e Gjykatës Themelore në _____ dhe në cilësi të organit të përmbaimit në këtë rast, është se me rastin e nxjerrjes së Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022, të mjeteve monetare të cilat i ka pasur në llogarinë e vet, _____ me seli në _____ e me në llogarinë bankare të kreditorit, _____ si dhe personave të tretë, i njëjti ka bërë shkelje të ligjit dhe atë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/ L-034 për AKP-në. Pra në rastin konkret, palë debitore në lëndën e përmbaimit, P.nr.001/20, ka qenë një Ndërmarrje Shoqërore (NSH), dhe e cila është likuidim dhe se Përmbauesi privat, _____ nga _____, si përmbaues privat, nga komunikimi me email i dt.3.11.2015 nga _____ për _____ sikurse të gjithë përmbauesit privat përmes e mailit të tyre, që nga dt.23 tetor 2015, përfshirë pra edhe Përmbauesin privat, _____ nga _____ kanë qenë në dijeni si dhe e kanë pranuar kopjen e Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), C - IV - 14 – 1607 të dt.15 tetor 2015 dhe i cili Udhëzim, ka të bëjë me pezullimin e të gjitha procedurave gjyqësore dhe se sipas këtij Udhëzimi, dhe pavarësisht nxjerrjes së aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Shk.II.nr.130/22 i dt.23.08.2022, Përmbauesi privat, _____ nga _____, si organ përmbaues, është dashur që të bëjë pezullimin e procedurës përmbaimore mirëpo i njëjti, nuk e ka bërë Pezullimin e procedurës përmbaimore në lëndën, P.nr.001/2020 e gjithnjë në frymën e respektimit të dispozitës së nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/ L-034 për AKP-në por edhe të Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015, i cili e vë në pah edhe zbatimin e nenin 10 të Shtojcës së Ligjit nr.04/ L-034 për AKP-në.

Komisioni, mori për bazë edhe pretendimin e Përmbauesit privat, se në bazë të aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Kom.Dh.Shk.II.nr.130/22 i dt.23.08.2022, kanë qenë të plotësuara kushtet ligjore për vazhdimin e procedurës së përmbaimit në lëndën e

përbarimit, P.nr.001/20 mirëpo në këtë rast disiplinor, nuk është objekt i shqyrtimit aktvendimi në fjalë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë por pretendimi i palës ankuese, se Përbaruesi Privat, a ka bërë shkelje disiplinore me veprimet e ndërmarra në lëndën e përbarimit, P.nr.001/2020 por Komisioni, vlerësoj se prapë se prapë, se Përbaruesi privat në fjalë dhe organ i përbarimit, duke qenë se ka qenë në dijeni se

ne seli në _____, është në likuidim si dhe se ka qenë në dijeni për Udhëzimin e DhPGJSK-së, C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015, e në të cilin është paraparë, pezullimi i çdo veprimi (çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit), e në rastin konkret të veprimit të arbitrazhit dhe atë në bazë të dokumentit të përbarimit (titullit ekzekutiv), Vendimit të Arbitrazhit, nr.15386/FM të dt.05 nëntor 2010 të Odës Komerciale Ndërkombëtare të Parisit, Përbaruesi Privat në fjalë, me ndërmarrjen e veprimeve të përbarimit, siç është lëshimi i Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 të mjeteve monetare në shumën prej 3,500,632.50 € nga llogaria bankare e _____

" me seli në _____ e në llogari bankare të kreditores, si dhe personave të tretë, Përbaruesi privat, _____ nga _____ i organ përbarues, ka bërë shkelje të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L - 034 për AKP-në e sipas të cilit, është dashur që ai si përbarues privat, dhe organ përbarues, të mos ndërmarr veprime të mëtejme por t'a bëjë pezullimin e procedurës së përbarimit në lëndën e përbarimit, P.nr.001/2020 derisa procedura e pezulluar mund të lejohej që të vazhdohej vetëm me miratimin e kërkesës së Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) e që në rastin konkret, nuk është miratuar lejimi i vazhdimit të procedurës së pezulluar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Komisioni, nuk mori për bazë për vendimarrje, provat e bashkangjitura nga pala ankuese, _____ përmes fjalës së saj përfundimtare të dt.20.02.2023, si dhe komentet e bëra nga Përbaruesi Privat në Vërejtjen e tij të dt.21.01.2023 pasi që palët në procedurë, në seancën dëgjimore të mbajtur me dt.16.02.2023, janë deklaruar njëzëri se heqin dorë nga komentet në fjalët përfundimtare të palëve në procedurë.

Komisioni, vlerësoj se nga interpretimi i dispozitave ligjore të cekura më lartë, erdhi në përfundimin se Përbaruesi Privat, _____ nga _____ ne veprimet e tij të përbarimit gjegjësisht me lëshimin e Urdhrit për transfer, P.nr.001/20 të dt.29.12.2022 të mjeteve monetare në shumën prej 3,500,632.50 €, dhe me mos ndërmarrjen e veprimit për pezullimin e procedurës së përbarimit nga vet ai si përbarues privat në lëndën, P.nr.001/20, ka bërë shkelje disiplinore dhe e tëra kjo në frymën e respektimit të dispozitës së nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/ L-034 për AKP-në por edhe të Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015, dhe i cili Udhëzim, e vënë në pah edhe zbatimin e nenin 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, e që sipas pikës III të këtij Urdhëzimi, procedurat e pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës së Dhomës së Posaçme, dhe se në rastin konkret, nuk ka pasur miratim të tillë të DhPGJSK-së për vazhdimin e procedurës së pezulluar, se ende nuk ka përfunduar përfunduar procedura gjyqësore e inicuar pranë DhPGJSK-së, sipas lëndës, C – IV - 14 – 1607 dhe atë sipas ankesës së _____ me seli në _____ të ushtruar kundër Vendimit gjegjës të Autoritetit të Likudimit (AL) derisa edhe në arsyetimin e Udhëzimit të DhPGJSK-së, C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015, parashihet se Shtojcën e Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në janë të obliguar, që t'a zbatojnë jo vetëm AKP-ja por edhe të gjitha institucionet tjera përfshirë edhe bankat e në rastin konkret, edhe përbaruesi privat, _____ nga _____ dhe si organ përbarues, pra këtë veprim të ndërmarr të Përbaruesit privat në fjalë, dhe mos veprimin e ndërmarrë nga vet ai si përbarues privat si dhe si organ i përbarimit, për pezullimin e procedurës përbarimore, në lëndën përbarimore, P.nr.001/2020, i njëjti, ka kryer shkeljen dicitinore si dhe me këtë veprim dhe me mosveprim të tij – mos pezullimin e procedurës përbarimore, i është

shkaktuar dëm i drejtëpërdrejtë, me seli në dhe kësisoj fondi i Ndërmarrjes Shoqërore në likuidim, është dëmtuar në atë masë sa që kërkesat e kreditorëve të tjerë të N.SH-së, të përcaktuar në kategori më të larta të prioritetit ose në kategori të njëjta, do të mbeten të pa përmbushura në rast se mjetet e tërhequra nga llogaria bankare e NSH, nuk do të kthehen, dhe se me këtë veprim (lëshimi i Urdhërit gjegjës për transfer) dhe mos veprimi - mos pezullimi i procedurës përmbartimore nga vet përmbartuesi privat në lëndën, P.nr.001/2020), i njëjti, ka bërë shkelje disiplinore në fjalë.

Komisioni Disiplinor për Përmbartues Privat, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore e me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij vendimi, mori për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masës dhe atë posaçërisht peshën dhe pasojat e shkeljeve, dëmin e shkaktuar, shkallën e përgjegjësisë të konstatuar në këtë rast disiplinor dhe dëmin e shkaktuar nga veprimi i tij përmbartimor i ndërmarr dhe mos veprimi i tij në lëndën përmbartimore, P.nr.001/2020 si dhe duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë, vendosi që Raportin, DPL.nr.01/2023 të dt.10.01.2023 të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës – Departamenti për Profesionë të Lira – Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbartuesi privat, nga dhe kërkesën e dt.10.01.2023 të palës ankuese, me seli në për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, nga t'i pranoj si të bazuara dhe ndaj Përmbartuesit privat, nga i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në t'i shqiptohet masa disiplinore, Shkarkimi nga detyra, dhe atë në bazë të nenit 368 paragrafi 1 nën paragrafi 5 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP) për shkeljen e konstatuar në këtë rast lëndor derisa Komisioni vlerësoi se çdo masë tjetër përveç masë së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, do të ishte pa ndikim tek përmbartuesi privat për përmirësimin e veprimeve të tij të përmbartimit dhe si organ përmbartues, pasi që i njëjti ka qenë në dijeni të potë se me veprimin e tij përmbartimor, bënë shkelje të Udhëzimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), C - IV -14 – 1607 të dt.15 tetor 2015 dhe ky veprim përmbartimor, është në kundërshtim të plotë edhe me praktikën e krijuar për këto raste nga vet përmbartuesit privat në nivel vendi.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi e në bazë të nenit 361 par. 2 lidhur me nenin 374 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.01/2023, dt.23.02.2023

Zëvendëskryesuesja Komisionit Disiplinor
Agron J. Hoxhaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që përmes padisë të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Kompetente e duke u bazuar në nenin 374 par.5 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).